





# EDUKIMI MJEDISOR



PRILL 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.



"Mjedisi është vendi ku të gjithë takohemi dhe kemi interes të përbashkët."

Lady Bird Johnson

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndër marrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale përgjatë muajit prill 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë 1 400

55 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 24

58 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 58



# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 22 Prill 2026 - Dita Botërore e Tokës

Kujdesi për tokën është thelbësor për jetën dhe mirëqenien e brezave të sotëm dhe të ardhshëm. Në shkollën e Mesme të Bashkuar “Lucë Agraja”, specialistët e Edukimit Mjedisor, në bashkëpunim me Shoqatën Cukali, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit, ku u trajtuan temat mbi rëndësinë e tokës, faktorët që ndikojnë në degradimin e saj dhe veprimet konkrete për mbrojtjen e saj. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe të nxisë përgjegjësinë qytetare për ruajtjen e mjedisit.

## 22 Prill 2026 - Dita Botërore e Tokës

Specialistët e edukimit mjedisor Shkodër u ndalën edhe në shkollën 9-vjeçare “Prek Gjoni”, ku zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit në kuadër të kësaj dite. Nëpërmjet punimeve artistike, pikturave, këngëve dhe recitimeve, nxënësit përcollën mesazhe të rëndësishme për mbrojtjen e tokës dhe dashurinë ndaj planetit. Aktiviteti nxori në pah përkushtimin dhe ndjeshmërinë e nxënësve për një mjedis më të pastër dhe të qëndrueshëm.

mjedis i pastër tokë e shëndetshme orë mjedisore  
zona të mbrojtura ekosistem sjellje në natyrë

# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 13 prill 2026 – Orë mjedisore në natyrë

Specialistët e AdZM Gjirokastrë organizuan një aktivitet të pasur dhe edukues në natyrë për nxënësit e shkollës “Gjerasim Qiriazi” (GDQ), duke kombinuar aventurën me njohjen e mjedisit natyror. Fillimisht, nxënësit zhvilluan një shëtitje në Kanionin e Lengaricës, një nga mrekullitë natyrore më të veçanta të jugut të Shqipërisë. Më pas, aktiviteti vijoi me rafting në Parkun Kombëtar të Vjosës, përgjatë rrjedhës së egër të Lumit Vjosa. Ky aktivitet shërbeu si një shembull i shkëlqyer i edukimit në natyrë, duke ndërthurur argëtimin me ndërgjegjësimin mjedisor dhe duke krijuar përvoja të paharrueshme për nxënësit.

## 15 prill 2026 – Orë mjedisore

AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me temë “Lulet dhe jeta në natyrë”, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Meleq Gosnishti”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e luleve në ekosistem dhe rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit dhe balancës natyrore. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe dashurinë për natyrën, si dhe kujdesin ndaj mjedisit që na rrethon.

## 16 Prill 2026 – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës

AdZM Gjirokastrë, me rastin e Ditës së Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës, zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 7-të të shkollës 9-vjeçare “Meleq Gosnishti”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e lakuriqëve të natës në ekosistem, rolin e tyre në kontrollin e insekteve dhe kontributin në ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti ishte interaktiv, me diskutime dhe pyetje, duke përcjellë mesazhin e respektit dhe mbrojtjes së çdo gjallese në natyrë.

ditë botërore vlera natyrore monument natyre  
mbrojta e natyrës orë mjedisore. flora e zonave të mbrojtura

# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 17 Prill 2026 – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës

Rëndësia e lakuriqëve të natës në ekosistem lidhet ngushtë me ruajtjen e ekuilibrit natyror, veçanërisht në kontrollin e insekteve. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II”, Ulëz, klasa e 9-të. Nxënësit u njohën me rolin e tyre në natyrë dhe nevojën për mbrojtjen e këtyre gjallesave, përmes diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese që nxitën ndërgjegjësimin për biodiversitetin.

## 20 prill 2026 – Orë Mjedisore

Njohja me botën ujore është thelbësore për të kuptuar rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve ujore. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me temë “Krijojmë një akvarium” me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kurt Cakoni”, Rreth-Baz. Nxënësit u angazhuan në aktivitete kreative për krijimin e një akvariumi, duke zhvilluar njohuri dhe interes për botën ujore.

## 28 prill 2026 – Orë Mjedisore

Dita e Tokës na kujton rëndësinë jetike të ruajtjes së tokës si burim bazë për jetën. Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Karic”, ku u trajtua ndikimi i ndotjes në mjedis dhe rëndësia e veprimeve të përditshme për mbrojtjen e tokës dhe mjedisit.

orë mjedisore ndërgjegjësim

biodiversitet mjedis i pastër ekosistem turizëm malor



# “EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të “Ditës së Tokës”, specialistët e AdZM Berat, në bashkëpunim me përfaqësues të Bashkisë, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “1 Maji”. Përmes diskutimeve dhe bashkëbisedimit me nxënësit, u theksua rëndësia e veprimeve të përditshme për mbrojtjen e mjedisit dhe u përcoll mesazhi për të vepruar sot, me qëllim garantimin e një mjedisi më të shëndetshëm për të ardhmen.




edukim mjedisor biodiversitet

ditë botërore riciklim mjedis i shëndetshëm



# “EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



## 9 Prill 2026 – Orë mjedisore

Njohja e biodiversitetit është thelbësore për kuptimin e lidhjes midis njeriut dhe natyrës. Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Arbëria”. Nëpërmjet bisedimeve dhe aktiviteteve edukuese, nxënësit u njohën me konceptin e biodiversitetit dhe rëndësinë e ruajtjes së gjallesave dhe habitateve natyrore, duke u angazhuar në lojëra dhe ushtrime ndërvepruese.

## 17 Prill 2026 – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës

Në kuadër të Ditës së Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Jubë”, klasa e 5-të (18 nxënës). Gjatë aktivitetit u trajtuan roli i lakuriqëve të natës në ekosistem, veçanërisht në kontrollin e insekteve dhe mbrojtjen e kulturave bujqësore. Nxënësit morën pjesë aktive përmes diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtyre gjallesave.

## 22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Dita Botërore e Tokës u shënua me një orë mjedisore të zhvilluar nga specialistët e AdZM Durrës në shkollën 9-vjeçare “Qazim Zenel Tepshi” në Krujë. Përmes bashkëbisedimit dhe aktiviteteve edukuese, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe rolin e secilit në ruajtjen e mjedisit, duke ndarë ide për një të ardhme më të pastër dhe të qëndrueshme.

## 29 prill 2026 – Riciklo për Tokën

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Jubë”, Durrës, u bënë pjesë e një aktiviteti mjedisor të organizuar nga specialistët e AdZM Durrës me fokus riciklimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Përmes aktiviteteve praktike dhe bashkëbisedimit, nxënësit u njohën me mënyrat e ndarjes dhe ripërdorimit të mbetjeve, duke zhvilluar ide kreative dhe duke u ndërgjegjësuar për rëndësinë e kujdesit ndaj mjedisit që në moshë të vogël.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



Ditë botërore orë mjedisore flora dhe fauna  
lakuriqi i natës habitate tokësore dhe ujore

**8 Prill 2026** – Dita Kombëtare e Dashmirësve të Kopshtit Zoologjik  
Rëndësia e njohjes dhe respektimit të kafshëve në kopshtet zoologjike lidhet ngushtë me edukimin mjedisor dhe zhvillimin e sjelljeve të përgjegjshme tek fëmijët. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së III të shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja” (35 nxënës). Gjatë aktivitetit u prezantuan kafshë të ndryshme të kopshteve zoologjike, u ndanë kuriozitete për to dhe u diskutua mbi rëndësinë e respektimit të rregullave gjatë vizitave, duke nxitur sjellje të përgjegjshme ndaj kafshëve dhe mjedisit.

**17 Prill 2026** – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës  
Në kuadër të Ditës së Lakuriqëve të Natës, e cila synon rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e këtyre gjallesave në ekosistem, stafi i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së V të shkollës 9-vjeçare “Nike Tome Prela” (35 nxënës). Gjatë aktivitetit u prezantua rëndësia e lakuriqëve të natës në ruajtjen e ekuilibrave natyrorë dhe në kontrollin e insekteve. Nxënësit u angazhuan gjithashtu në punë krijuese, duke realizuar figura simbolike të lakuriqëve të natës, çka ndihmoi në forcimin e ndërgjegjësimit dhe interesit për mbrojtjen e biodiversitetit.

**22 Prill 2026** – Dita Botërore e Riciklimit  
Dita Botërore e Tokës thekson rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe kujdesit ndaj burimeve natyrore. Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VI të shkollës 9-vjeçare “Marash Gjoni” në Rrile. Aktiviteti u shoqërua me prezantim mbi mbrojtjen e tokës dhe punime krijuese me temë “Tokë e lumtur – Tokë e trishtuar”, ku nxënësit shprehën mesazhe për ruajtjen e natyrës dhe ndërgjegjësimin mjedisor.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 8 prill 2026 – Aktivitet mbjelljeje

Në kuadër të nismave për edukimin mjedisor, specialistët e AdZM Tiranë në bashkëpunim me Shoqatën “Shqipëria Gjelbëron” zhvilluan një aktivitet mbjelljeje në oborrin e shkollës 9-vjeçare “Tufinë”, me nxënës e klasës së 9-të. Nxënësit u angazhuan në mbjelljen e 12 fidanëve të llojeve të ndryshme si dafinë, tuje dhe selvi, duke kontribuar në gjelbërimin e ambientit shkollor dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë mjedisore.

## 17 Prill 2026 – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës

Në kuadër të kësaj dite, u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët e AdZM Tiranë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Tufinë”. Nxënësit u angazhuan në aktivitete krijuese duke realizuar figura lakuriqësh me materiale të riciklueshme dhe piktura me temë natyrën. Gjithashtu, specialistët shfaqën një video informuese mbi jetën dhe rolin e lakuriqëve të natës në ekosistem, duke rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tyre.

## 22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”. Nxënësit u angazhuan në aktivitete ndërgjegjësuese dhe praktike si mbjellje dhe pastrim, duke përcjellë mesazhe mbi rëndësinë e veprimeve të vogla që sjellin ndryshime të mëdha në mbrojtjen e Tokës dhe mjedisit.

## 28 prill 2026 – Aksion pastrimi në shkollën “Tufinë”

Në kuadër të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Tiranë realizua një aksion pastrimi bashkë me nxënësit në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Tufinë”. Nxënësit u angazhuan në pastrimin e hapësirave përreth shkollës, duke dhënë një shembull konkret të përgjegjësisë qytetare dhe kujdesit ndaj mjedisit, si dhe duke nxitur kulturën e ruajtjes së pastërtisë.

ndërgjegjësim tokë e shëndetshme

krijimtari ditë botërore



## 29 Prill 2026 – Art me materiale natyrore

Nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Ymer Lala”, klasa e 6-të, realizuan punime artistike me materiale natyrore si lule dhe degë, të cilat u vendosën në korniza druri duke krijuar kompozime kreative dhe pranverore. Aktiviteti u zhvillua nga specialistët e AdZM Tiranë dhe synoi të forcojë njohuritë mbi vlerat e natyrës dhe rëndësinë e përdorimit të përgjegjshëm të materialeve natyrore, duke nxitur respektin dhe dashurinë për mjedisin.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



## 2 prill 2026 – Orë mjedisore në Parkun Kombëtar “Shebenik”

Në bashkëpunim me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shefqet Dosku” Dorëz, u zhvillua një orë mjedisore në kuadër të Parkut Kombëtar “Shebenik”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me vlerat natyrore të parkut, me fokus te flora dhe bimët mjekësore. Tema e prezantuar u sugjerua nga vetë nxënësit dhe u shoqërua me diskutime interaktive dhe materiale informuese.

## 7 Prill 2026 – Dita Botërore e Shëndetit

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Isuf Gjura” Kuturman, pranë Peizazhit të Mbrojtur “Kuturman–Qafë Bush”. Gjatëaktivitetit u realizua edhe një pastrim i ambientit shkollor dhe rreth tij, me mesazhin se shëndeti injeriut lidhet ngushtë me një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

## 8 Prill 2026 – Dita Botërore e Dashamirësve të Kopshtit Zoologjik

Në kuadër të Ditës së Kopshtit Zoologjik, u zhvillua një aktivitet edukativ me nxënësit e shkollës9-vjeçare “Vilson Blloshmi”. Nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve dhebiodiversitetit përmes prezantimeve, punimeve artistike dhe ngjyrosjeve, duke përcjellëmesazhin për mbrojtjen e specieve dhe natyrës.

## 16 prill 2026 – Orë mjedisore mbi biodiversitetin

Në bashkëpunim me projektin “PAMANCA”, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Isak Alla” në Zgosht. Nxënësit u njohën me vlerat e ParkutKombëtar “Shebenik”, me theks të veçantë te biodiversiteti dhe rrëqebulli i Ballkanit si specie e rrallë dhe e mbrojtur.

Parku Kombëtar “Shebenik” flora dhe fauna

edukim mjedisor zona të mbrojtura jeta e egër aktivitet pastrimi



## 17 Prill 2026 – Dita e Vlerësimit të Lakuriqëve të Natës

Në shkollën 9-vjeçare Fushë Studën u zhvillua një orë mjedisore me temë lakuriqët e natës. Nxënësit u njohën me rolin e tyre në ekosistem dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre. Ata realizuam gjithashtu punime krijuese, duke kombinuar edukimin me aktivitetin artistik.

## 21 prill 2026 – Aktivitet pastrimi në Stravaj

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Ahmet Elezi” Stravaj, u realizuan një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonës përreth. Aktiviteti kishte si qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për mbrojtjen e natyrës dhe kujdesin ndaj mjedisit.

## 22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të Ditës së Tokës, u zhvillua një aktivitet pastrimi me pjesëmarrjen e AdZM Elbasan, organizatave mjedisore dhe nxënësve nga shkolla të ndryshme të qytetit. Aktiviteti u shoqërua edhe me një ecje në shtegun “Qafë Shapkë – Maja e Qafë Shapkës”, duke përcjellë mesazhin për mbrojtjen e planetit.

## 23 prill 2026 – Aktivitet pastrimi në Spathar

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Spathar, pranë Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Polis”, u realizua një aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe rreth saj. Aktiviteti synoi edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit të pastër.

## 29 prill 2026 – Orë mjedisore në Hotolisht

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Alliu” Hotolisht, pjesë e Parkut Kombëtar “Shebenik”. Nxënësit morën pjesë në një aktivitet pastrimi dhe u ndërgjegjësuam mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit kujetojnë.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 7 Prill 2026 – Dita Botërore e Shëndeti

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit, specialistët e AdZM Fier organizuan një aktivitet ecjeje në natyrë në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Fier. Gjatë aktivitetit, nxënësit përcollën mesazhe mbi rëndësinë e natyrës dhe përfitimet që ajo sjell për shëndetin fizik dhe mendor, duke u ndërgjegjësuar për rolin e mjedisit në një jetë të shëndetshme.

## 17 prill 2026 – Vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Rako S. Gjermeni” (Krutje) vizituan Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku u njohën me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e parkut. Aktiviteti u zhvillua me asistencën e specialistëve të AdZM Fier, të cilët udhëzuan nxënësit në eksplorimin dhe kuptimin e rëndësisë së ruajtjes së natyrës.

## 21 prill 2026 – Aktivitet krijues në natyrë (fluturimi i balonave)

Në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, nxënës nga shkollat e Lushnjës dhe Divjakës zhvilluan një aktivitet të mbushur me ngjyra dhe energji, duke ngritur balona shumëngjyrëshe në qiell. Aktiviteti promovoi kreativitetin, bashkëpunimin dhe dashurinë për natyrën, duke krijuar një atmosferë argëtuese dhe edukative.

## 22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës, specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me nxënësit e Tirana International School, zhvilluan një aktivitet pastrimi në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta. Aktiviteti u fokusua në njohjen e vlerave natyrore të parkut dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

orë mjedisore edukim ndërgjegjësim

tokë e shëndetshme park kombëtar aksion pastrimi



## 24 prill 2026 – Aksion kombëtar pastrimi i bregdetit

Në kuadër të aksionit kombëtar për pastrimin e bregdetit, AdZM Fier në bashkëpunim me Bashkinë Fier, Forcat e Armatosura, Prefekturën Fier dhe nxënësit e shkollës “Janaq Kilica” realizuan një aksion pastrimi në plazhet e Darëzezës dhe Pishë Poros, me synim mbrojtjen e mjedisit bregdetar dhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar.

---

## 29 prill 2026 - Vizitë në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Jorgji Dilo”, Elbasan, vizituan Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku u njohën me biodiversitetin dhe vlerat natyrore të parkut, duke mësuar mbi rëndësinë e ruajtjes së ekosistemeve të tij.

---

## 29 prill 2026 - Orë mjedisore në natyrë

Stafi i AdZM Fier, në bashkëpunim me nxënësit e shkollës “Protagonistët”, Tiranë, zhvilloi një orë mjedisore në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta. Aktiviteti u fokusua në njohjen e vlerave natyrore të parkut dhe lagunës së Karavastasë, përmes vizitës në Kandalin e Vaut, ku nxënësit vëzhguan shpendë të ndryshëm dhe morën shpjegime mbi rëndësinë ekologjike të habitatit dhe ruajtjen e biodiversitetit.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



## 1 Prill 2026 – Mbjellje fidanësh

Në kuadër të aktiviteteve mjedisore, specialistët e AdZM Kukës organizuan një aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Bushtric”, me fokus rëndësinë e pyjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjatë aktivitetit u trajtua roli i pyjeve në ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe ndikimin pozitiv në balancën klimatike. Nxënësit morën pjesë në mbjelljen praktike të 50 fidanëve të pishës, duke u njohur më nga afër me rëndësinë e pyllëzimit dhe kujdesit ndaj hapësirave të gjelbra. Në aktivitet morën pjesë 25 nxënës.

## 3 Prill 2026 – Dita Botërore e Gjallesave Ujore

Në kuadër të Ditës Botërore të Gjallesave Ujore, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Beslidhja e Malësisë” në Tropojë. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e gjallesave ujore dhe rolin e tyre në ruajtjen e balancës ekologjike. Nxënësit u njohën me biodiversitetin e faunës ujore, rëndësinë e lumenjve, liqeneve dhe zonave të lagështa, si dhe me kërcënimet që vijnë nga ndotja, ndryshimet klimatike dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore.

## 22 Prill 2026 – Dita Botërore e Tokës

Dita Botërore e Tokës u shënuar nga specialistët e AdZM Kukës përmes një aktiviteti krijues me temë “Tokë e lumtur & Tokë e trishtuar”, me nxënësit e klasës së pestë të shkollës 9-vjeçare “Krumë”. Aktiviteti kishte për qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve mbi ndikimin që kanë veprimet e përditshme të njeriut në mjedis dhe nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme. Nxënësit identifikuan veprimet pozitive dhe negative ndaj mjedisit dhe realizuan vizatime me temë mbrojtjen e Tokës.




## 28 prill 2026 – Shënim dhe pastrim shtegu

Specialistët e AdZM Kukës realizuan aktivitetin për shënimin dhe pastrimin e shtegut turistik "Ruga auto – Ujvara Lojme" brenda Parkut Natyror Korab-Koritnik. Aktiviteti synoi përmirësimin e kushteve për vizitorët, rritjen e sigurisë dhe orientimit përgjatë shtegut, si dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror. Nëpërmjet kësaj nisme u promovua turizmi i qëndrueshëm dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

## 28 prill 2026 –Aktivitet pastrimi në lumin e Valbonës, PK Alpet e Shqipërisë

Specialistët e AdZM Kukës iu bashkuan aktivitetit të organizuar nga CoPLAN, VisAlbania dhe COSV, me pjesëmarrjen e studentëve, institucioneve vendore dhe organizatës GreenAI, për pastrimin e lumit të Valbonës në Parkun Kombëtar "Alpet e Shqipërisë". Aksioni vullnetar synoi ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e një prej pasurive më të rëndësishme natyrore të vendit. Përmes angazhimit të përbashkët u përcoll mesazhi i kujdesit ndaj natyrës dhe përgjegjësisë për ta trashëguar atë të pastër tek brezat e ardhshëm.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



edukim mjedisor mbjellje fidanësh ndërgjegjësim

flora e pasur turizëm rëndësia e bletëve

mjedis i shëndetshëm fauna e egër zona të mbrojtura

## 7 prill 2026 – Turizmi në Zonat e Mbrojtura

Specialistët e AdZM Korçë, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Shaban Hoxha” në Plasë, me temë “Turizmi në Zonat e Mbrojtura”. Aktiviteti synoi ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e natyrës. Gjatë diskutimit, nxënësit treguan interes për mënyrat se si mund të vizitohen zonat e mbrojtura pa dëmtuar biodiversitetin dhe habitatet natyrore. U trajtuan ndikimet pozitive dhe negative të turizmit në mjedis, si dhe rëndësia e sjelljes së përgjegjshme ndaj natyrës.

## 8 Prill 2026 – Kafshët e Kopshtit Zoologjik

Në shkollën “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” në Korçë, specialistët zhvilluan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e klasës së katërt, kushtuar kafshëve të kopshtit zoologjik. Aktiviteti kishte për qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve mbi mirëqenien e kafshëve dhe rëndësinë e mbrojtjes së specieve. Nxënësit diskutuan mbi kushtet e jetesës së kafshëve në kopshte zoologjike, dallimet mes jetës në natyrë dhe në robëri, si dhe rolin që kanë këto institucione në edukim dhe ruajtjen e biodiversitetit.

## 8 prill 2026 – Riciklimi dhe bota nënujore

Në “Kopshtin nr. 5” në Korçë, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një aktivitet edukues me temë riciklimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Fëmijët u njohën me rëndësinë e ripërdorimit të materialeve dhe ndikimin pozitiv që ka riciklimi në ruajtjen e natyrës. Gjatë aktivitetit, ata krijuan objekte të ndryshme të frymëzuara nga bota nënujore duke përdorur materiale të riciklueshme si letër, plastikë dhe karton. Aktiviteti nxiti kreativitetin, bashkëpunimin dhe ndërgjegjësimin për reduktimin e mbetjeve.

## 8 prill 2026 – Rëndësia e Bletëve në Natyrë

Fëmijët e grupit 1 në “Kopshtin nr. 5” në Korçë morën pjesë në një aktivitet edukues të organizuar nga specialistët e AdZM Korçë kushtuar bletëve dhe rolit të tyre në ekosistem. Gjatë aktivitetit, ata mësuan mbi rëndësinë e bletëve në pllenimin e bimëve dhe prodhimin e mjaltit, si dhe për mënyrat e mbrojtjes së tyre dhe habitatit natyror.

---

## 8 prill 2026 – Ushqimi i Shëndetshëm dhe Mjedis

Në kuadër të aktiviteteve mjedisore të zhvilluara në “Kopshtin nr. 5” në Korçë, specialistët e AdZM Korçë realizuan një tjetër aktivitet me temë ushqimin e shëndetshëm dhe ndikimin e tij në jetën e përditshme. Fëmijët mësuan mbi rëndësinë e konsumimit të frutave dhe perimeve, si dhe diskutuan për zgjedhjet ushqimore që ndihmojnë shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Aktiviteti u shoqërua edhe me pjesëmarrjen e prindërve, të cilët sollën gatime të përgatitura së bashku me fëmijët, duke krijuar një atmosferë festive, bashkëpunuese dhe edukuese.

---

## 9 prill 2026 – Njohja me Kafshët e Zonave të Mbrojtura

Në shkollën “Stavri Themeli” në Korçë, në grupin parashkollor, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një aktivitet edukues mbi kafshët që jetojnë në zonat e mbrojtura. Fëmijët u njohën me specie të ndryshme përmes figurave për ngjyrosje, lojërave edukative dhe ushtrimeve për lidhjen e kafshëve me habitatet e tyre. Aktiviteti përfshiu gjithashtu zgjidhjen e fjalëkryqeve dhe ushtrime argëtuese mbi natyrën dhe biodiversitetin.



## 10 prill 2026 – Vizitë edukuese në Parkun e Cangonjit

Nxënësit e klasave 8 dhe 9 të shkollës “Shaban Hoxha” në Plasë zhvilluan një vizitë edukative në Parkun e Cangonjit. Gjatë aktivitetit, ata eksploruan mjedisin natyror të parkut dhe u njohën nga afër me bimësinë dhe gjallërinë e kësaj hapësire të gjelbër. Specialistët diskutuan me nxënësit mbi rëndësinë e ruajtjes së parqeve dhe hapësirave natyrore për jetën dhe mjedisin.

---

## 17 prill 2026 – Mbjellje fidanësh

Në shkollën “Raqi Qirinxi” në Korçë, nxënësit e klasës së dhjetë zhvilluan një aktivitet praktik me mbjelljen e fidanëve në vazo ekologjike. Gjatë aktivitetit, ata mësuan mbi procesin e rritjes së bimëve dhe rëndësinë që kanë pemët dhe bimësia për cilësinë e ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit. Nxënësit treguan përkushtim dhe bashkëpunim gjatë mbjelljes së fidanëve, duke reflektuar mbi përgjegjësinë që secili ka ndaj natyrës dhe gjelbërimit.

---

## 20 prill 2026 – Aksion mbjelljeje

Fëmijët e grupit 3 të “Kopshtit nr. 9” në Korçë morën pjesë në një aktivitet mbjelljeje të organizuar nga specialistët e AdZM Korçë në oborrin e institucionit, ku së bashku mbollën fidanë bliri dhe qershie të egër. Gjatë aktivitetit, ata mësuan mbi procesin e mbjelljes dhe rëndësinë e pemëve për ajrin e pastër dhe mjedisin. Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë bashkëpunimi dhe entuziazmi, duke krijuar një përvojë edukative dhe argëtuese për fëmijët.



## 20 Prill 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Korçë, në oborrin e shkollës “Raqi Qirinxhi” në Korçë organizuan një aksion mbjelljeje me nxënësit e klasës së dhjetë. Gjatë aktivitetit u mbollën fidanë pishe të zeze dhe bli, me qëllim gjelbërimin dhe përmirësimin e mjedisit shkollor. Nxënësit u angazhuan aktivisht në procesin e mbjelljes dhe mësuan mbi rëndësinë e pemëve në ruajtjen e ajrit të pastër dhe biodiversitetit. Aktiviteti ndikoi në forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj natyrës.

---

## 20 prill 2026 – Aksion mbjelljeje në Shkollën “Profesionale Teknike”

Oborri i shkollës “Profesionale Teknike” në Korçë u gjallërua nga energjia dhe përkushtimi i nxënësve të klasës së njëmbëdhjetë, të cilët morën pjesë në një aksion mbjelljeje fidanësh bliri. Të angazhuar në çdo hap të procesit, nxënësit jo vetëm mbollën pemë të reja, por edhe mësuan mbi rëndësinë që ka kujdesi për hapësirat e gjelbra dhe ndikimi pozitiv i pemëve në mjedis. Aktiviteti përcolli mesazhe mbi përgjegjësinë qytetare dhe nevojën për të kontribuar në krijimin e një ambienti më të pastër dhe më të gjelbër

---

## 21 prill 2026 – Aksion mbjelljeje në Kodrat e Qytetit

Në një atmosferë plot energji dhe bashkëpunim, nxënësit e klasave 4, 5 dhe 6 të shkollës “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”, së bashku me specialistët e AdZM Korçë, zhvilluan një aksion mbjelljeje në kodrat e qytetit. Gjatë aktivitetit u mbollën rreth 100 fidanë, duke kthyer këtë nismë në një shembull të bukur të angazhimit për natyrën. Fëmijët mësuan nga afër për rëndësinë e pemëve në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit, ndërsa përjetuan një eksperiencë edukative dhe argëtuese në natyrë.



## 22 prill 2026 – Mbjellje lulesh në shkollën “Papa Kristo Negovani”

Në kuadër të aktiviteteve mjedisore, nxënësit e klasës së pestë të shkollës “Papa Kristo Negovani” në Ersekë zhvilluan një aktivitet mbjelljeje lulesh në oborrin e shkollës. Përveç pjesës praktike, nxënësit mësuan edhe mbi pjesët biologjike të lules dhe funksionin e tyre. Aktiviteti ndërthurte edukimin teorik me praktikën dhe nxiti tek fëmijët kujdesin për natyrën dhe estetikën e mjedisit.

## 23 prill 2026 – Aksion pastrimi në shtegun e Gështenjave

Në bashkëpunim me nxënësit e klasave 8 dhe 9 të shkollës “Kozma Basho” në Pogradec dhe stafin e AdZM, u zhvillua një aksion pastrimi në Shtegun e Gështenjave. Aktiviteti kishte për qëllim pastrimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe ujërave. Nxënësit kontribuan aktivisht në sistemimin e hapësirës dhe promovimin e një mjedisi më të pastër dhe të shëndetshëm.

## 24 prill 2026 – Aksion pastrimi në bregliqenin e Linit

Në shkollën “Myredin Bashalli” në Lin u zhvillua një aksion masiv pastrimi përgjatë bregliqenit, me pjesëmarrjen e nxënësve dhe institucioneve të ndryshme. Aktiviteti synoi pastrimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve natyrore. Përmes bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët, pjesëmarrësit kontribuan në krijimin e një mjedisi më të pastër dhe më të sigurt për komunitetin.

## 25 prill 2026 – Aksion pastrimi në Kalanë e Pogradecit

Specialistët e AdZM Korçë, së bashku me nxënësit e shkollës “Kozma Gjokë Basho” në Pogradec, së bashku me institucione të ndryshme, zhvilluan një aksion pastrimi në kalanë e qytetit. Gjatë aktivitetit u pastruan mbetjet dhe u sistemuan hapësirat përreth monumentit kulturor dhe natyror. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, si dhe forcimin e frymës së bashkëpunimit dhe



# “EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



**1 prill 2026** – Orë Mjedisore mbi njohjen e rëndësisë së zonave të mbrojtura Shëtitje në natyrë me studentë të huaj të interesuar për mjedisin, e zhvilluar në formën e një ore mjedisore në Zonën e Mbrojtur Pishë Poro–Nartë. Gjatë aktivitetit studentët u njohën me rëndësinë e zonës së mbrojtur për mjedisin dhe biodiversitetin, si dhe u prezantuan shpendët karakteristikë të zonës përmes birdwatching.

**14 prill 2026** – Orë mjedisore

Specialistët e Adzm Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me studentët e Universitetit të Salzburgut, në bashkëpunim me Prof. Kujtim Onuzi dhe Dr. Arben Kociu, me fokus rëndësinë e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe punën e zhvilluar ndër vite për ruajtjen e tyre. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte thellimi i njohurive mbi rëndësinë e zonave të mbrojtura dhe forcimi i praktikave efektive për mbrojtjen e tyre.

**22 Prill 2026** – Dita Botërore e Tokës

Në kuadër të Ditës Botërore të Tokës, u zhvillua një workshop në formën e një ore mjedisore me fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin për mbrojtjen e mjedisit. Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me AdZM Vlorë, Rektoren e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe stafin pedagogjik të fakulteteve përkatëse.

Studentët morën pjesë përmes prezantimeve, ideve dhe diskutimeve mbi sfidat aktuale mjedisore, duke kontribuar në shkëmbimin e njohurive dhe praktikave për mbrojtjen e natyrës. Ky aktivitet synoi forcimin e edukimit mjedisor dhe nxitjen e rolit aktiv të të rinjve në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

edukim mjedisor ndërgjegjësim zona të mbrojtura  
breshka detare biodiversitet ekosistem ujor